

Datë 24/01/2022

## **KALLZIM PENAL**

- KALLZUES:** **Erion Veliaj**, Kryetari i Bashkisë Tiranë, në cilësinë e aksionerit të Klubit të Futbollit Tirana.
- ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale të “*Falsifikimi i dokumentave*” dhe, “*Shpërdorim detyre*”, “parashikuar nga neni 186 dhe 248 i Kodit Penal.
- KUNDËR:** **Z. Ilir Shulku**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit.  
**Z. Ardian Haçi**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 280, 283 të K.Pr.Penale dhe neni 186, 248 i Kodit Penal.
- DREJTUAR:** Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane.  
Drejtorisë Vendore së Policisë së Shtetit Tiranë.
- PËR DIJENI:** Prokurorisë së Përgjithshme.

*I nderuar Z. Prokuror!*

*I nderuar Drejtor i Policisë Vendore Tirane*

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale parashtrijmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

### **RRETHANAT E FAKTEVE**

Kallëzimi mbështetet në veprimet e kundraligjshme të ndërmarra nga shtetasit Ilir Shulku dhe Ardian Haçi, në procedurën e zgjedhjes së Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës. Në vijim ju parashtrijmë në mënyrë përmbledhëse rrethanat e faktit e vërtetuar me prova mbështetëse, konkretisht:

Rezulton se me datë 24.01.2022, rreth orës 15:00, ka qenë planifikuar të zhvillohej mbledhja e delegatëve për zgjedhjen e Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës, ku në garë kanë qënë dy kandidatë, konkretisht z. Krenar Alimehmeti, si dhe z. Eduard Prodani, i cili është tërhequr pak pas nisjes së mbledhjes, pasi janë konstatuar një sërë shkeljesh ligjore dhe mungese absolute transparence, për shkak se nuk janë vënë në dispozicion paraprakisht lista e delegatëve me të drejtë vote.

Ju bëjmë me dije se Bashkia Tiranë është aksionere e Klubit të Futbollit Tirana dhe pjesë e Shoqatës Rajonale e Futbollit të Tiranës, e cila përbëhet nga 41 persona juridikë, ku secili prej anëtarëve përzgjedh delegatët përfaqësues me të drejtë vote, në zgjedhjen e kreut të ri të shoqatës.

Në ambientin ku ishte planifikuar të zhvillohej mbledhja kanë qënë prezent 67 anëtarë nga 41 që duhet të jenë, ku 24 anëtarë kanë qënë persona anonim (delegatë jo-legjitim) të përzgjedhur në mënyrë të kundraligjshme nga përfaqësues të FSHF-së, me qëllim ndikimin në procesin e zgjedhjes së Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës, duke paracaktuar rezultatin.

Konstatohen shkelje të kundraligjshme në kuadër të zhvillimit të mbledhjes përkatëse, konkretisht:

1. Në listën jo të plotë dhe të manipuluar, të vënë në dispozicion para pak kohësh, anëtarëve të shoqatës (personave juridik), me justifikimin për thirrjen e mbledhjes së delegatëve.
2. Ka informacione që në mbledhjen e datës 24.01.2022 të orës 15 të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tirane, me telefon nga Sekretari i Pergjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit Ilir Shulku është kërkuar e kanë marrë pjesë në këtë mbledhje persona që nuk kanë asnjë lloj lidhje me shoqatën në kundërshtim të plotë me statutin e federatës që përcakton që delegatët duhet të jenë punonjës të anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tirane. Personat për të cilët ka një informacion të tillë janë:
  - a. Altin Kello
  - b. Ajson Lala
  - c. Ervin Bukaci
  - d. Aldi Masha
3. Në moszbatimin e procedurës administrative për zhvillimin e mbledhjes së delegatëve, ku në rastin konkret nuk është zbatuar procedura standarte nga Komisioni i Verifikimit, në lidhje me identifikimin e plotë të delegatëve me të drejtë vote, si dhe lista përkatëse e delegatëve legjitim nuk i është vënë në dispozicion kandidatëve paraprakisht.
4. Zhvillimi i mbledhjes mbi kuorumin e nevojshëm, me pjesëmarrjen e 67 anëtarëve nga 41 që duhet të jenë, ku 24 anëtarët prezent kanë qënë persona anonim (delegatë jo-legjitim). Në këto kushte cmojmë së janë përdorur lista

fiktive votuesish, duke falsifikuar nënshkrimet e delegatëve legjitim me të drejtë vote, të cilët kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes.

5. Njoftimet e anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë janë njoftuar nëpërmjet një emaili i cili nuk administrohet nga anetaret e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, por sipas informacioneve, keto emaile janë hapur nga punonjës të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe administrohet po nga ata. Duke futur në këtë mënyre apo hequr të dhëna në mënyre të paautorizuar nga sistemi elektronik në administrimin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, me pasoje pavorshmerine e njoftimeve dhe vendimeve të kësaj shoqate.

Shkeljet nga personat përgjegjës janë bërë me një qëllim të vetëm, ndikimin apo paracaktimin e rezultatit të zgjedhjes së Kreut të Shoqatës së Futbollit të Tiranës, sipas interesave klienteliste të kreut aktual të FSHF-së.

Ndodhur para këtij fakti, kërkojmë kryerjen e një hetimi të plotë nga organi i akuzës, në lidhje me identifikimin e plotë të listës së delegatëve pjesmarrës në mbledhjen e zhvilluar me datë 24.01.2022, për zgjedhjen e Kreut të Shoqatës së Futbollit të Tiranës. Kërkojmë në mënyre të menjehershme sekuestrimin gjithë dokumentacionin e hartuar nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe nga Shoqata Rajonale e Futbollit Tiranë, si dhe të gjithë serverat e këtyre dy institucioneve me qëllim sigurimin e provave për faktet penale të referuara dhe ndalimin e vijimit të shkeljeve të metejshme që do sjellin si pasoje deformimin kriminal të vullnetit të anetareve të këtyre OJF-ve. Kërkojmë marrjen e masave të menjehershme dhe ndjekjen penale të shtetasit Ilir Shulku dhe Ardian Haçi, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, si personat përgjegjës për administrimin e dokumentacionit elektronik dhe fizik të institucioneve që përfaqësojnë.

## **LIGJI I APLIKUESHËM**

Kodi i Procedurës Penale, në nenet e tij 280 dhe 283 parashikon se:

*Neni 280*

### ***Marrja dajeni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dajeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.....*

*Neni 283*

*Çdo person që ka marrë dajeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.....*

1. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 186 parashikon se: *Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga*

*personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.*

2. Neni 186/a i Kodit Penal parshikon se: *“Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet.”*

**Objekti i kesaj vepre penale** jane mardheniet juridike te vendosura per te siguruar veprimtarine e rregullt te administrates publike, te organizatave, firmave te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

**Nga ana objektive**, vepra penale kryhet ne dy forma kryesore:

- a) me ane te falsifikimit te dokumentave, ndryshim identiteti, moshes etj.
- b) me perdorimin e dokumenteve te falsifikuara...

Referuar praktikës gjyqësore qendrimi i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ne lidhje me kete veper penale shprehet se: vepra penale e falsifikimit te dokumentave nuk kerkon i element te saj vetem qellimin e fitimit, por mjafton qe te pasqyrohen ne to te dhena te paverteta.

Vepra penale e falsifikimit te dokumentave kryhet ne rrethana cilsuese:

- a) bashkepunim
- b) kur kryhet me shume se nje here.
- c) kur falsifikimi ka sjell pasoja te renda, rastet kur falsifikimi eshte bere me shumice.

**Subjekt i vepres penale**, eshte cdo person qe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem, i cili falsifikon dokumentin.

**Nga ana subjektive**, vepra penale e falsifikimit te dokumentave apo perdorimit te dokumentave te falsifikuara kryhet vetem me dashje direkte, do të thotë se i pandehuri me dashje bën ndryshime të pjesshme ose falsifikon tërësisht të dhënat në dokument, ose e përdor dokumentin e falsifikuar duke e ditur që ai dokument është i tillë.

## **2. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 248, parashikon se:**

*Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.*

Që të jemi përpara rastit të konsumimit të një vepre penale, duhen analizuar këto elemente të figurës së veprës penale: **objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive.**

Që të konkludohet se të një subjekt ka konsumuar veprën penale “Shperdorimi i detyres” duhet që të evidentohet pikë së pari ekzistenca e të gjithë elementëve të kësaj figure vepre penale, në veprimet e tij. Ashtu siç trajtohen në teorinë e së drejtës penale materiale, elementët e veprës penale janë katër, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, të cilët duhet të bashkëekzistojnë njëkohësisht në mënyrë që një person të merret në përgjegjësi penale.

*Referuar nenit 248 te K. Penal,ligjvenesit ka parashikuar mbrojtje te posaçme per marrdheniet juridike te vendosura nga shteti me ligj apo me akte nenligjore per te siguruar veprimtarine normale te aparatit shteteror si dhe mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te ligjeshme te shtetasve ose shtetit;cenimi i te cilave passjell pergjegjesi penale. Nga interpretimi i dispozites se mesiperme arrijme ne perfundimin se legjislatori, marredheniet qe kane te bejne me permbushjen e rregullt zbatimin e ligjeve, si dhe per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te ligjshme te shtetasve, i ka cilesuar si marredhenie juridike te rendesishme, te cilat mbrohen posaçerisht nga legjislacioni penal.*

**1. Objekt i veprës penale**, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, janë mbrojtja e marrëdhënieve juridike të parashikuara me ligj ose me akte nenligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shteteror, si dhe mbrojtjen dhe interesat e ligjshme të shtetasve ose të shtetit, të mbrojtura posaçerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

**2. Nga ana objektive**, krimi i shperdorimit të detyres kryhet me veprime aktive të kundraligjshme ose moskryerjen e veprimeve që përben mospermbushje të rregullt të detyres. **Per krimin e shperdorimit të detyres është element i domosdoshem i anes objektive është konstatimi i lidhjes shkakësore të drejteperdrejte midis veprimit dhe mosveprimit të kundraligjshem, mospermbushje e rregullt e detyres dhe demtimit të interesave të ligjshme të shtetit, shtetasve dhe të personave të tjere juridik.**

Duke ju referuar interpretimit literal të dispozites dhe praktikës gjyqësore, elementet objektive të kësaj vepre penale janë:

- a) Kryerja ose moskryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin,
- b) veprimet ose mosveprimet përbejnë mospermbushje të rregullt të detyre,
- c) veprimet ose mosveprimet kryhen nga një person që ushtron funksione publike,
- d) veprimet ose mosveprimet i kanë sjelle personit ose personave të tjere përfitime materiale ose jomateriale ose kanë demtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridike,

**3. Subjekt i kësaj vepre penale**, mund të jetë subjekt i posaçem, çdo punonjes i ngarkuar me funksion publik. Referuar ligjit të sportit, sporti në Republikën e

Shqipëria është një veprimtari me interes publik në Republikën e Shqipërisë dhe shteti e ka deleguar këtë funksion publik tek Federatat Sportive (neni 7 dhe neni 17 i ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin në Republikën e Shqipërisë”).

**4. Nga ana subjektive**, vepra penale e shpërdorimit të detyrës kryhet kurdoherë me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj veprimeve ose mosveprimeve dhe me pakujdesi ndaj pasojave të ardhura.

Për sa parashtruar si më sipër, vërtetohet qartësisht se me veprimet e ndërmarra nga shtetasi Ardian Haçi, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, janë konsumuar elementët e figurave të veprave penale të sipërcituara dhe ky shtetas duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale. Këtij kallëzimi do i bashkëngjisim edhe provat mbështetëse të cilat do të vërtetojnë pretendimet e bazuara, në cilësinë e palës kallëzuese.

**Për sa më sipër, i kërkojmë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, “Falsifikimi kompjuterik” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 186, 186/a dhe 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Ilir Shulku me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ardian Haçi me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë.**

**Kallzues  
Erion VELIAJ**